

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Berat , me 13\_.10.2023

## **PROCES VERBAL**

### **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

#### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

- **OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje pajisje mobilerie per shkollen e mesme ”Babë Dudë Karbunara“ Berat

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):;**  
**39160000-1 mobilje shkollore**

- - **VLERA E FONDIT LIMIT:**
  - Sigurimi i ofertës 2% e fondit limit sipas nenit 30, pika 3, te VKM nr.285, datë 19.05.2021 ne vleren :

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 21, pika 2, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të autoriteti/enti kontraktor **Bashkia BERAT** ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VECANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: *Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të konratës;b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës*, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres se Fondit Limit.

**Argumentimi:** Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me pikën 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se:

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar konratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.*

*Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japid informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës; ne piken 1 dhe piken 2/b te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b)vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.*

#### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Ne piken 1 dhe piken 2/b te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhan maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku percaktohet; Pika2/b: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;* Duke qene se kjo procedure prokurimi bazuar ne vleren e fondit limit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ’Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ’Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktiveve ne perputhje me Ligjin nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistik të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përm bushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe demostron se Operatori Ekonomik ka aftësi financiare për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të kërkuar cilësie. Gjithashtu ky kriter është vendosur referuar nenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistik të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

### **2.3. Për kapacitetin teknik:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave te mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- a) Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme të realizuar me një ent publik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përbushjen me sukses të kontratës ku te shenohen, vlera, afati i perfundimit te kontrates dhe/ose fatura tatimore të shitjes, te plotësuara sipas kërkesave te legjislacionit ne fuqi ku shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur faturat të plotësuara sipas kërkesave të

legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet timore ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", ne te cilin parashikohet se:

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar konratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar konratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të konratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se:

*4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të konratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të konratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përbushjen me sukses të konratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të konratës ose/dhe fatura timore të shitjes, të plotësuara sipas kërkësave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura timore të shitjes, të plotësuara sipas kërkësave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet timore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjeshet me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

**2.3.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 4 (kater) punonjës. Për përbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përbledhës të vetëdeklarimit.

*Ndërsa ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzoj pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë:*

- *Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Shtator 2023.*
- *Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shtator 2023.*

Për stafin e sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontrat e punes

*Kriteri konsiderohet i përbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nen 26 “Formulari Përbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër.*

**Argumentimi:** Ky kriteri është vendosur në përputhje me Nenin 77 pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe ne Rekomandimin e APP Nr. 8197, date 03.09.2018 Prot “Mbi hartimin e kritereve per kualifikim per procedurat e prokurimit mallra, pune, sherbime”.

Për shkak se kemi të bëjmë me një procedurë furnizim-vendosje ,ky kriter gjen mbeshtetje edhe ne VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

Referuar kriterit te mesiperme për realizimin me sukses dhe brenda afateve është kërkuar prezenca në stafin e operatorit ekonomik e një numri minimal prej 4 të punësuarisht duke marrë në konsideratë nevojën per prodhimin e mobilejve , sherbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen neper vende te te gjithe artikujve ne adresen e autoritetit kontraktore.

**2.3.3** Operatori Ekonomik duhet të disponojë **1 (nje )automjet transporti ne pronesi ose me qira , me qëllim transportin e mallrave,**

Për mjetet që janë në pronesi, duhet të paraqitet :

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (certifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- a) kontrata e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

*Kriteri konsiderohet i përbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër*

**Argumentimi:** Ky kriteri, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe tregon që ofertuesi ka kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 5 germa ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kërkesa e mesiperme i sherben AK si garanci se operatori ekonomik fitues ka mjetet e nevojshme per te realizuar me sukses implementimin e kontrates brenda afateve.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën 1 vjecare të garancisë së mallrave që kerkohen të prokurohen nga data e dorëzimit të artikujve objekt prokurimi, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirembajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 1, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kerkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit

### 2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim **të paktën 1 (një) ambient për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi.**

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes një deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Vendodhja	Statusi
1		Pronesi/qira/perdorim

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit

### 2.3.5 Operatori ekonomik duhet te paraqese një deklarate me ane te se ciles merr persiper te kryeje sherbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen neper vende te te gjithe artikujve ne adresat e autoriteteve kontraktore, te perfshira ne kete procedure prokurimi.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

### 2.3.6 Operatori ekonomik ne lidhje me artikujt objekt prokurimi dhe/ose lëndët e para të prodhimit të artikujve objekt prokurimi te percaktuar shtojcën 6 Formulari i sasisë dhe Grafiku i ekzekutimi, qe do te paraqese, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës sipas tabelës nr. 1.

- në rast se OE pjesmarrëse është tregtues i mallrave objekt prokurimi plotësojë të dhënat sipas tabelës nr. 1.

Tabela 1

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjinës
1		
2		
Etj.,		

- në rast se OE pjesmarrëse është prodhues i mallrave objekt prokurimi plotësojë të dhënat sipas tabelës nr. 2.

Tabela 2

Nr.	Emertimi i produktit (Lënda e parë)	Vendi i origjinës
1		
2		
Etj.,		

### **Shënim 7.1:**

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prane AK, perpara publikimit tw fituesit paraprak cdo dokument qw verteton origjinwn e artikujve objekt prokurimi sipas tabelës së mësipërme.

### **Shënim 7.2:**

Në rast se operatori edhe tregon edhe përpunon mallrat objekt prokurimi të plotësoj tabelat për secilin artikull qe përpunon dhe/ose tregon.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërmë b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërbën autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartit CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbytjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi

**2.3.5** Operatori Ekonomik duhet kete dhe te paraqesë certifikatat e konformitetit me Standartet ISO si me poshtë:

- a. Certifikate: **EN –ISO 9001:2015**-Sistemi i Menaxhimit të cilesisë;

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizëm kombëtar i akreditimit, ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njojur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat ISO duhet të jenë brenda periudhës së vlefshmërisë. Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili operator ekonomik duhet të dispozojë certifikatat ISO sipas zërave/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përmbytja e standardeve ISO është thelbësore, dhe i siguron AK se operatori ekonomik fitues eshte serioz dhe ka kaluar

procese vleresimi ne lidhje me respektimin e standardeve te mesiperme te cilat kane lidhje me objektin e prokurimit.

Konkretisht:

**Certifikate: EN- ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të cilesisë** - Përmbushja e standardit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së mallrave që parashikon kontrata. Nisur nga proceset e punes dhe sherbimeve qe ai ofron, gjykohet e aryeshme qe operatori ekonomik proceset e punes se tij, t'i bazoje ne standarde boterore, te cilat ne menyre direkte ndikojne ne cilesi, shpejtesi, efikasitet dhe te sherbimeve te ofruara. Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori ekonomik zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkuesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specififikimet teknike janë vendosur nga grapi i pune i krijuar per hartimin e e projektit ,preventivit, afatit te punimeve dhe relacionin teknik , në përputhje me nenin 4,pika 7, 38, nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 40, pika 2, të V.K.M-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Specififikimet teknike gjenden bashkëngjitur D.S.T-ve në S.P.E.*